



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64 dhe nenin 43 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-212 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike të Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058, parimit të transparencës të financave publike, neni 120 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 21.10.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nxjerr këtë:



### VENDIM

#### Për publikimin e Raporteve Vjetore Financiare të Paaudituar të Partive Politike për vitin 2019

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim për publikimin e Raporteve Vjetore Financiare të Paaudituar të Partive Politike për vitin 2019.
- II. Obligohet Zyra që gjatë përgatitjes së materialeve për publikim të siguroj mbrojtjen e të dhënave personale sipas ligjit nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- III. Obligohet SKQZ që të publikoj në ueb faqen zyrtare të KQZ-së Raportet Vjetore Financiare të Paaudituar të Partive Politike për vitin 2019 me shënimin 'Këto raporte financiare janë të pa audituara dhe mund të pësojnë ndryshime dhe saktësime gjatë procesit të auditimit'.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Duke u bazuar në nenin 15 të Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, subjektet politike të regjistruara ia dorëzojnë KQZ-së për çdo vit raportin vjetor financiar më së largu deri më 1 mars të vitit vijues në mënyrën e paraparë nga KQZ. Në bazë të nenit 19 të Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, KQZ duhet t'i publikoj dhe t'i mbaj të publikuar të gjitha raportet vjetore financiare të subjekteve politike së bashku me raportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike në faqen e saj zyrtare më së largu deri më 30 qershor të vitit pasues.

Duke pasur parasysh që raportet vjetore financiare auditohen nga auditorët e zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës përmes Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe ky proces nuk ka përfunduar ende, KQZ duke respektuar edhe parimin e transparencës në raport me publikun vendos si në dispozitiv për publikimin e raporteve ashtu siç janë dhe të shoqëruara me tekstin 'Këto raporte financiare janë të pa audituara dhe mund të pësojnë ndryshime dhe saktësime gjatë procesit të auditimit'.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Valdete Daka, Kryetare